

VENDIM
Nr. 500, datë 29.8.2018

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR ASISTENCË TEKNIKE,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E
PËRGATITJES SË NJË STUDIMI FIZIBILITETI PËR PROJEKTE TË
INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT, NË ZONAT BREGDETARE JUGORE TË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit për asistencë teknike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit, në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë, me një grant në shumën prej 200 000 (dyqind mijë) dinarësh kuvajtianë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FONDI KUVAJTIAN
PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/ Tech/ 11G6___215 12 dhjetor 2017

Sh. së Tij Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Shkëlqesia Juaj,

Lënda: Granti i Asistencës Teknike për Financimin e Përgatitjes të një Studimi Fizibiliteti për Projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare Jugore të Shqipërisë

Kam kënaqësinë të informoj Shkëlqësinë tuaj që Bordi i Drejtorëve të Fondit të Kuvajtit ka miratuar në datën 9.2.2017 një grant në formën e asistencës teknike në shumën e KD 200,000/- (vetëm dyqind mijë dinarë kuvajtianë) për të realizuar përgatitjen e një studimi fizibiliteti teknik-ekonomik për projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare të Jugut në Republikën e Shqipërisë që do të mbikëqyren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Asistenca Teknike duhet të sigurohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e mëposhtme:

1. Studimet e sipërpërmendura do të merren përsipër nga një Konsulent Ndërkombëtar i kualifikuar dhe me përvojë, në një shoqëri të përbashkët me Konsulentin Kuvajtian, që do të përzgjidhet nga një listë e përzgjedhur që përfshin të paktën 7 firma prej atyre që janë ftuar me marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, nëpërmjet Fondit shqiptar të Zhvillimit dhe Fondit Kuvajtian. Shoqëri të përbashkëta të konsulentëve mund të paraqesin propozime për detyra të tilla në përputhje me Termat e Referencës të detajuara, të hartuara gjithashtu me marrëveshje ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Fondit Kuvajtian. Pas marrjes së propozimeve të Konsulentit, këto propozime do të vlerësohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në konsultim me Fondin Kuvajtian, dhe përzgjedhja

përfundimtare e Konsulentit do të bëhet me marrëveshje ndërmjet nesh. Fondi shqiptar i Zhvillimit do të përgatisë kontratën me Konsulentin e përzgjedhur në lidhje me detyrën që i është ngarkuar dhe draft kontrata do t'i paraqitet Fondit Kuvajtian për miratim, dhe më pas do të nënshkruhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Konsulentët.

2. Fondi Kuvajtian do të mbulojë koston e studimeve të sipërpërmendura deri në shumën e KD 200,000/- detyrimi i Fondit Kuvajtian është deri në kufirin e shumës së alokuar për Asistencën Teknike të përcaktuar më sipër.

3. Fondi Kuvajtian do t'i paguajë drejtpërdrejt konsulentëve që marrin përsipër kryerjen e Studimeve të mësipërme, shpenzimet dhe tarifat që iu takojnë këtyre konsulentëve në përputhje me termat e Marrëveshjes së Konsulencës të nënshkruar me ta, si dhe çdo amendim të tyre që mund të miratohet nga Fondi Kuvajtian deri në kufirin e përcaktuar në paragrafin pararendës.

4. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, do t'u sigurojë konsulentëve, të cilët janë ngarkuar me Studimet e kërkuara, të gjithë asistencën dhe lehtësirat që iu nevojiten për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe me kujdesin maksimal.

5. Nëse Asistenca Teknike e Fondit Kuvajtian, në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara më sipër, merr miratimin e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, ju lutem dëshmoni këtë aprovim nëpërmjet nënshkrimit të formës së pranimi, pjesë e kësaj letre, dhe ta ktheni atë te neve ose të mundësoni nënshkrimin e saj në emër të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nga një person i autorizuar në mënyrën e duhur, në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe të na e ktheni së bashku me një autorizim të tillë.

6. E drejta e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, nëpërmjet Fondit shqiptar të Zhvillimit, për të kryer tërheqje nga Asistenca Teknike do të përfundojë në datën 31.12.2018 ose në një datë tjetër për të cilën herë pas here, qeveria dhe Fondi Kuvajtian mund të bien dakord.

Me respekt,

Hesham Al- Waqayan

Zëvendësdrejtore i përgjithshëm

Forma e pranimi

Ne konfirmojmë pranimin tonë dhe miratimin e Asistencës Teknike të përcaktuar në këtë letër sipas kushteve të përcaktuara më sipër.

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë

Nga: Arben Ahmetaj

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

(Përfaqësuesi i Autorizuar)

28.6.2018